

Deklaratë në gjuhën e thjeshtë

[Nossal Institute for Global Health*, University of Melbourne]



Projekt: Si po kaloni?

Professor Barbara McPake (Studiuese përgjegjëse)
Tel: +61 3 83449299 Email: ni-info@unimelb.edu.au

Hyrje

Ju faleminderit për pjesëmarrjen në këtë projekt kërkimor. Teksti më poshtë do tju jap më tepër informacion mbi projektin në mënyrë që të vendosni nëse dëshironi të merrni pjesë në këtë projekt.

Ju lutemi të lexoni këtë informacion me kujdes. Mund të pyesni për çfarëdo gjë që nuk kuptoni ose që keni dëshirë të informoheni më tej.

Pjesëmarrja juaj është vullnetare. Nuk është e nevojshme të merrni pjesë nëse nuk dëshironi. Gjithashtu mund të ndërpreni pjesëmarrjen në çdo kohë.

Për çfarë bën fjalë ky studim?

Synimi kryesor i këtij projekti është të mbledhi të dhëna dhe të vlerësoj impaktin e pandemisë COVID-19 në ekonomi, shëndetësi dhe mirëqënien e individëve dhe familjeve në përgjithësi në të gjithë botën. Këto impakte dhe sesi ndryshojnë për individ në vende të ndryshme Kërkimi do të eksploroj sesa të mëdha janë The research will explore how large these impacts are, how they vary across individuals in different countries, by their social and economic circumstances, and over time. The project is funded by the Nossal Institute and the School of Population and Global Health at the University of Melbourne.

Çfarë do të më kërkohet të bëj?

Nëse do pranoni të merrni pjesë, ju do të perijigjigjeni pesë minuta mbi gjendjen tuaj shëndetësore, mirëqënien, gjendjen ekonomike dhe disa informacione rreth jush. Ky pyetësor parashikohet të zgjase rreth 30-45 minuta.

Ju mund të merrni pjesë nëse ato janë dakort dhe nuk janë detyruar tju japin miratim. Ne rekomandojmë që ti lexoni këtë deklaratë individuale për të cilet do të plotësoni këtë pyetësor dhe ti kerkoni leje që ta plotësoni nëse do të merrni pjesë.

Studimi shpreson që të mbledhi të dhëna mbi ndryshimin e situatës suaj me kalimin e kohës. Nëse na jepni një adresë emaili, ne mund t'ju kontaktojmë për të marrë pjesë në sondazhet e ardhshme në internet që janë pjesë e këtij studimi çdo 3 muaj deri në 31 Dhjetor 2022.

Ju gjithashtu mund të zgjidhni t'i përgjigjeni këtij studimi sa herë që dëshironi pa ndonjë kontakt nga ne. Sidoqoftë, nuk keni asnjë detyrim të ofroni adresën tuaj të emailit, ose të merrni pjesë në këtë studim, as tani e as në të ardhmen.

Cilat janë përfitimet e mundshme?

Ne nuk mund të premtojmë se ju do të përfitoni drejtpërdrejt nga pjesëmarrja juaj në këtë projekt kerkimor, as nuk do t'ju paguajmë ose do t'ju rimbursojmë për pjesëmarrjen tuaj. megjithatë, përgjigjet tuaja mund të çojnë në përgjigje më efektive të politikave për të adresuar sfidat e paraqitura nga COVID-19. Cilat janë rreziqet e mundshme?

Rreziqet që lidhen me këtë studim përfshijnë humbjen e mundshme të konfidencialitetit (për shembull nëse na jepni një adresë emaili të identifikueshme dhe faqja e internetit është e hakuar). Për të reduktuar rrezikun e identifikimit të individëve, përgjigjet tuaja për këtë studim (së bashku me të tjerët) do të ruhen në një server të sigurt të vendosur në Universitetin e Melburnit në formën e paidentifikuar (dhe nuk do të lidhen me çdo informacion - siç janë adresat e postës elektronike) që mund të gjurmohet mbrapsht tek ju. Për më tepër, rezultatet nga studimi do të raportohen në formë agregate, për grupet e popullsisë dhe vendet, dhe jo individualisht. Numri i përgjigjeve të sondazhit të mbledhura për këtë projekt pritet të jetë shumë i madh, duke kufizuar më tej rrezikun e përgjigjeve tuaja specifike që te gjurmohen te ju nga qeveria ose agjensitë ndërkombëtare. Sidoqoftë, ju lutemi merrni parasysh këto para se të vendosni të vazhdoni.

Është gjithashtu e mundur që ju të mund të përjetoni ndjenja trishtimi ose stesimi për shkak të përgjigjes së pyetjeve në lidhje me ndikimet sociale, shëndetësore dhe ekonomike të COVID-19. Në këto rrethana, ne rekomandojmë të kërkonit shërbime suporti të ofruara nga organizatat e komunitetit ose shërbimet qeveritare në zonën tuaj. Ju gjithashtu mund të jeni në gjendje t'i qaseni këtyre shërbimeve përmes telefonit.

A duhet të marr pjesë?

Jo. Pjesëmarrja është plotësisht vullnetare. Ju mund të tërhiqeni në çdo kohë duke i shkruar studiuesit përgjegjës Profesor Barbara McPake (shiko më poshtë për detajet e kontaktit). Sidoqoftë, ne do t'i mbajmë të dhënat e dhëna nga ju deri sa te marrim njoftimin tuaj për tu tërhequr me afat të pacaktuar. Kjo për shkak se ndikimet e COVID-19 ka të ngjarë të zgjasin për shumë vite dhe menaxhimi i ngjarjeve të ardhshme mund të informohet nga përvoja gjatë kësaj epidemie. Ne gjithashtu do të ruajmë përgjigjet tuaja në përputhje me kërkesat tona ligjore dhe rregullatore. Ne gjithashtu mund të ndajmë përgjigjet tuaja e anonimizuar (përgjigje që nuk mund lidhen me ju) me të tjerët ne baze te ligjit për qëllime të punës kerkimore, ose për arsye të interesit publik.

A do të dëgjoj për rezultatet e këtij projekti?

Pas përgjigjeve tuaja te këtij pyetesori, ju do te kemi mundesi te shikoni ne kete faqe interneti rezultate te perzgjedhura nga ky studim ne forme tabelash dhe grafikesh. Për më tepër, analizat bazuar në të dhënat e këtij studimi pritet të publikohen në revista shkencore, të paraqitura në konferenca profesionale dhe si artikuj të shkurter gjithashtu dhe opinioneve të hapura. Këto artikuj do të jetë e disponueshme edhe përmes lidhjeve në këtë faqe interneti.

Cfarë do të ndodhë me informacionin rreth meje?

Të dhënat tuaja do t'i ruajmë për një periudhë të pacaktuar. Kjo për shkak se ndikimet e COVID-19 ka të ngjarë të zgjasin për shumë vite dhe menaxhimi i ngjarjeve të ardhshme mund të informohet nga përvoja gjatë kësaj epidemie. Ne gjithashtu do të ruajmë përgjigjet tuaja në përputhje me kërkesat tona ligjore dhe rregullatore. Ne gjithashtu mund të ndajmë përgjigjet tuaja e anonimizuar (përgjigje që nuk mund lidhen me ju) me të tjerët ne baze të ligjit për qëllime të punës kerkimore, ose për arsye të interesit publik.

Për të reduktuar rrezikun e identifikimit të individëve, përgjigjet tuaja për këtë studim (së bashku me të tjerët) do të ruhen në një server të sigurt të vendosur në Universitetin e Melburnit në formën e pidentifikuar (nuk do të lidhen me çdo informacion - siç janë adresat e postës elektronike) që mund të gjurmohet mbrapsht tek ju dhe do të menaxhohen nga një ekip i Nossal Institute.

Ku mund të marr informacione të mëtejshme?

Nëse dëshironi më shumë informacione rreth projektit, ju lutemi kontaktoni studiuesin përgjegjës Professor Barbara McPake (Tel: +61 3 83449299 Email: ni-info@unimelb.edu.au).

Me kë mund të kontaktoj nëse kam ndonjë shqetësim në lidhje me projektin?

Ky projekt kerkimor është aprovuar nga Komiteti i Etikës së Kërkimit Njerëzor i Universitetit të Melbournit. Nëse keni ndonjë shqetësim ose ankesë në lidhje me sjelljen e këtij projekti kerkimor, të cilin nuk dëshironi ta diskutoni me ekipin e kërkimit, duhet të kontaktoni Menaxherin në Etikën e Kërkimit Njerëzor, Etikën e Kërkimit dhe Integritetin, Universiteti i Melbournit, VIC 3010. Tel: +61 3 8344 2073 or Email: HumanEthics-complaints@unimelb.edu.au. Të gjitha ankesat do të trajtohen me konfidencialitet. Në çdo korrespondencë, ju lutemi jepni emrin e ekipit kerkimor, emrin ose numrin e identitetit etik të projektit kerkimor.

**Nossal Institute for Global Health*: Bazuar në School of Population and Global Health at the University of Melbourne, the Nossal Institute for Global Health (<https://mspgh.unimelb.edu.au/centres-institutes/nossal-institute-for-global-health/about-us/about-the-nossal-institute>) është emëruar për nder të Sir Gustav Nossal dhe angazhimit të tij për përkthimin e kërkimeve mjekësore në shëndetësi për të gjithë.

Instituti është themeluar në vitin 2006 për të mbrojtur shëndetin publik të komuniteteve në nevojë. Misioni i Institutit është të forcojë cilësinë, përbalueshmërinë dhe gjithëpërfshirjen e sistemeve shëndetësore përmes përgjigjeve praktike të kërkimit, mësimit dhe zhvillimit për çështje bashkëkohore shëndetësore.